




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

Lënda: Amendament

Zotit Gramoz RUÇI

KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË

I nderuar Z. Ruçi,

Mbështetur në nenin 75 pika 4 të Rregullores së Kuvendit propozoj që në projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar”, të bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pas nenit 1, të shtohet neni 1/1 me përmbajtje si vijon:

“Neni 1/1

Neni 4 të riformulohet si vijon:

1. Në çdo njësi pakete apo paketimi të produkteve të duhanit duhet të figurojnë mesazhe paralajmëruese për dëmet që shkakton në shëndet përdorimi i duhanit. Këto mesazhe duhet të jenë të shkruara në gjuhën shqipe, qartë, dukshëm dhe lexueshëm. Ato duhet të zënë 50 për qind ose më shumë të sipërfaqes së shfaqur, por jo më pak se 30 për qind të faqes kryesore. Forma dhe teksti i mesazheve miratohen nga KNMSHPD-ja dhe riformulohen periodikisht.
2. Paketat e duhanit duhet të plotësojnë standartet e paketimit të thjeshtë. Paketimi i thjeshtë bëhet në ngjyrat bardhë e zi ose dy ngjyra të tjera në kontrast sipas përcaktimeve të KNMSHPD. Në paketim nuk vendoset asgjë tjetër përveç emrit të markës, emrit të produktit dhe / ose emrin e prodhuesit, detajet e kontaktit dhe sasia e produktit në paketim, pa logot apo veçori të tjera, me përjashtim të paralajmërimeve shëndetësore, pulla tatimore dhe informacione ose shënime të tjera të miraturara nga KNMSHPD.
3. Ndalohet çdo lloj reklame apo promovim brenda paketës, ose e bashkangjitur në paketim, apo në cigare individuale ose produkte të tjera të duhanit”.

2. Pas nenit 8, të shtohet neni 8/1, me përmbajtje si vijon:

“Neni 8/1

Në nenin 22, të shtohet një paragraf i dytë, me përmbajtje si vijon:


“Ngarkohet KNMSHPD-ja, që në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit, të miratojë formatin e paketimit të thjeshtë brenda 3 muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji”.”

3. Neni 9 të riformulohet si vijon:

**“Neni 9
Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”, me përjashtim të pikës 2 të nenit 4 që hyn në fuqi në datën 1 korrik 2021; paragrafit të parë, të dytë dhe të tretë, të nenit 6, të këtij ligji, që hyjnë në fuqi 48 muaj pas botimit në “Fletoren zyrtare” dhe të paragrafit të katërt, të nenit 6, të këtij ligji, që hyn në fuqi 24 muaj pas botimit në “Fletoren zyrtare”.”

Deputeti


Ilir Beqaj

RELACION

Duhani është e provuar tashmë që dëmton shëndetin e gjysmës së njerëzve që konsumojnë atë aktivisht dhe ndikon negativisht në 30 % të njerëzve që ndikohen drejtpërdrejt pasivisht nga produktet e duhanit. Ndikimin më të madh negativ duhani e ka në sëmundjet kardiovaskulare dhe në ato tumorale.

Heqja e markës në paketimin e cigareve synon të shkurajojë duhanpirjen duke hequr asocimin pozitiv të markës në konsumin e duhanin.

Për këtë ka filluar të zbatohet edhe paketimi i thjeshtë (plain packaging) i cili quhet ndryshe edhe paketim standard, neutral, gjenerik apo homogjen.

Për herë të parë është zbatuar në Australi në vitin 2012. Më tej është shtrirë edhe në vende të tjera përfshirë Kanada, Belgjikë, Francë, Hungari (fillimi i zbatimit është shtyrë për në 2022), Irlandë, Mbretërinë e Bashkuar, Norvegji etj. Në Turqi do të fillojë të zbatohet në shtator 2019. Në Holandë dhe në Slloveni do të fillojë të zbatohet në vitin 2020.

Në 31 maj 2016, në ditën botërore të luftës kundër duhanit, Organizata Botërore e Shëndetësisë i ka bërë thirrje qeverive të vendeve anëtare të bëhen gati për paketimin e thjeshtë.

Edhe amendamenti i mësipërm kërkon që Shqipëria të fillojë të zbatojë paketimin e thjeshtë. Parashikohet të fillojë të zbatohet nga 1 korrik 2021 për t'i lënë kohë industrisë prodhuese të bëjë përgatitjet e nevojshme.

Detajet e paketimit të thjeshtë të miratohen brenda tre muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit nga Komiteti Ndërsektorial për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit.

Deputeti


Ilir Beqaj